REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
18. 07. 2022
Njësia Org. 05 | Shif.klasif. 47 | Nr. Prot. 1320 | Nr.i faqeve 2

| Fondi i Sigurimit Shëndetësor<br>Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Fondi i Sigurimit Shëndetësorë për vitin e përfunduar 31.12.2021 | | | |
|---|---|---|---|
| **Raporti i Kapitujve** | **Institucionet përgjegjëse Departamenti** | **Aktivitetet** | **Afati i Implementimit** |
| **Çështja B1- Mos arsyetim i mjeteve për trajtim mjekësor te subvencionuara** | | | |
| **Rekomandimi B1**<br><br>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara. Me tutje, kjo çështje të adresohet përmes ndryshimeve të UA. | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Divizioni për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike. | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka ndërmarrë masa dhe ka rishikuar Udhëzimin Administrativ për programin e TMJISHP-ve dhe e ka dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë për aprovim. Udhëzimi i ri është i bazuar në konkurrencë dhe transparencë si dhe siguron mekanizma të kontrollit. | I implementuar më datë 14.07.2022 |

| Çështja A1- Nën vlerësim i detyrimeve kontingjente ne PFV | | | |
|---|---|---|---|
| **Rekomandimi A1**<br><br>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle me të forta në përgatitjen dhe prezantimin e informatave në PFV, në mënyrë që ato të prezantojnë gjendjen e plotë dhe të saktë të gjitha zërave. | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore<br><br>Divizioni Ligjor<br><br>Zyrtari Kryesor Financiar | Fondi ka mbajtur takime zyrtare me zyrtaret përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Zyrtaret e Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës, për të definuar saktë Regjistrin e detyrimeve kontingjente, i cili ka paqartësi qysh nga ndarja e këtyre institucioneve. | Ky rekomandim do të implementohet në tremujorin e fundit të vitit 2022, përkatësisht adresimi do të behet edhe në pasqyra financiare të këtij viti. |
| **Çështja A1- Mangësi ne procedimin e pagesave** | | | |
| **Rekomandimi C2**<br><br>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të forcojnë kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtaret përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave. | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore<br><br>Zyrtari Kryesor Financiar<br><br>Zyrtari i Prokurimit | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, pas pranimit të raportit ka ndërmarrë masa të menjëhershme dhe e ka adresuar rekomandimin e dhënë. Të gjitha shpenzimet tani realizohen në pajtueshmëri të plotë më Rregullën financiare 041/2013/MF. | I implementuar, menjëherë pas pranimit të raportit final. |